



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:900446  
Datë: 26.04.2024  
Numri i dokumentit: 05625889

C.A.P.1498/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari individual Besnik Bislimaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Raiffesien Bank Kosovë (RBKO), me seli në rr. “UÇK”, nr.51 në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Credica L.L.C, me seli në Prishtinë, rr. UCK, kati I-rë, kompleksi Qafa, kundër debitorëve A. M. H., me adresë në lagjen Ulpiana në Prishtinë, F. I. SHPK, të cilën e përfaqëson I. H. me adresë në Arbëri dhe F. I., të cilën e përfaqëson K. L., me adresë në lagjen Emshir, për përmbarimin e dokumentit përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorëve, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1904/2019, të datës 16.11.2021, më datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e debitorëve F. I. SHPK, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1904/2019, të datës 16.11.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, ka vendosur si vijon: REFUZOHET SI I PABAZUAR prapësimi i debitorëve A. M. H., me adresë në lagjen Ulpiana në Prishtinë (garantues), Flora Impex SHPK, të cilën e përfaqëson I. H. me adresë në Arbëri (garantues) dhe F. I., të cilën e përfaqëson Kastriot Lumi, me adresë në lagjen Emshir (garantues), i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit, numër P.nr.261/16, i datës 24.09.2019 të lejuar nga Përmbaruesi privat M. R. nga Prizreni.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë kanë paraqitur debitorët me pretendimet se të njëjtit nuk janë garantues të kredi marrësit A.M. mirëpo vetëm kanë nënshkruar për veturën të cilën ia kanë shitur të njëjtit dhe e cila ka qenë në emrin e kompanisë F. I..

Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjendet se kreditori të ketë paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, nenit 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se:

*-Ankesa e debitorëve është e pabazuar.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Raiffesien Bank Kosovë (RBKO), me seli në Prishtinë, me datë 19.12.2012, pranë Gjykatës Komunale në Therandë, ka parashtruar propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit përmbartimor, përkatësisht Marrëveshjes mbi Kredinë Nr.200669060, të datës 12.07.2010, përmes të cilit kanë kërkuar që të sekuestrohet kolaterali i përshkruar si në propozimin për përmbartim si dhe tu bllokohen llogaritë nëpër të gjitha bankat komerciale në emër të të gjithë debitorëve.

Me anë të parashtresës së datës 28.06.2016, kreditori ka bërë kërkesë për transferimin e lëndës tek përmbartuesi privat ndërsa Gjykata Themelore në Prizren, Dega në Suharekë duke vepruar sipas kësaj parashtresë ka nxjerrë konkluzionin E,nr.1363/12, të datës 28.06.2016 përmes të cilit e ka transferuar komplet lëndën tek përmbartuesi privat M. S. R..

Kreditori përmes parashtresës së datës 30.08.2019, ka bërë plotësimin e propozimit dhe njëherit me datë 24.09.2019, ka parashtrues plotësimin e propozimit për përmbartim, paraqitur kundër debitorëve Agim Morina dhe "F. I. SHPK" me përfaqësues I. H. dhe Kastriot Lumi, për sekuestrimin e kolateralit.

Përmbartuesi Privat M. S. R. duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhër P.nr.261/2016, të datës 24.09.2019, me të cilin e ka caktuar përmbartimin sipas dokumentit përmbartimor si më lartë, duke e pranuar si dokument përmbartimor, i cili i plotëson kushtet për ta lejuar përmbartimin.

Kundër urdhrit përmbartimor, debitorët brenda afatit ligjor kanë paraqitur prapësim dhe atë me datë 09.10.2019 me pretendimet se propozimin për përmbartim e kundërshtojnë si pjesërisht të pabazuar për shkak se të njëjtit nuk kanë qenë garantues në lidhje me kredinë e marrë pranë Raiffaisen Bank por kanë qenë vetëm nënshkrues të dokumentit në lidhje me lënien e veturës Toyota Yaris si peng për kredinë e marrë.

Me përgjigje në prapësim, kreditori i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e palës debitore me pretendimet se prapësimi i paraqitur është plotësisht i pabazuar ngase nuk përmban asnjërin nga shkaqet e përmendura për paraqitjen e prapësimit sipas dispozitave të LPP-së dhe i njëjti nuk është i mbështetur në prova ashtu që i njëjti është bërë vetëm me qëllim të zvarritjes së procedurës. Ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet në tërësi ndërsa Urdhri për Përmbarrim P.nr.261/16, i datës 24.09.2019 të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimit, me aktvendimin e atakuar ka vendosur që ta refuzojë si të pabazuar prapësimin e debitorëve, të ushtruar kundër Urdhrit mbi caktimin e Përmbarrimit P.nr.261/16, të datës 16.11.2021, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se “ gjykata vlerësoj se organi përmbarrimor ka lejuar përmbarrimin në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së dhe se dokumenti në bazë të cilit është iniciuar propozimi për përmbarrim është titull ekzekutiv e kjo konform dispozitave ligjore nga neni 5 të Plotësim Ndryshimit të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore dhe nenit 21, 22 dhe 73 të LPP-së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, gjyqtari i Gjykatës së Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, të pa themelta qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese ngase në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se propozimi për përmbarrim është bërë në bazë të dokumentit përmbarrimor dhe se me dispozitat e nenit 5, neni 22 i ligjit bazik, pas nën par.1.7, paragrafi 1.7a të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139, për Procedurën Përmbarrimore është paraparë se dokument përmbarrues është edhe “kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut”. Organi përmbarrues e cakton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues dhe dokumentit të besueshëm, siç e përcakton dispozita e nenit 21 të LPP-së, e në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për ekzekutim në bazë të dokumentit përmbarrues të paraparë me dispozitën e nenit 22 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore. Dokument përmbarrues, sipas nenit 22 par.1 nënpar.1.7a të Ligjit për Ndryshim dhe Plotësimin për Procedurën Përmbarrimore është edhe “kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut”, ashtu që në këtë rast Marrëveshja mbi Kredi Nr.200669060, e datës 12.08.2010 së bashku me shtojcën Marrëveshjen mbi Pengun janë dokumente përmbarrimore dhe i plotësojnë kushtet për të qenë të përmbarrueshme konform dispozitave të LPP-së pasi që janë të përcaktuara pengun dhe mjetet e lëna peng dhe e njëjta është regjistruar pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht pranë Zyrës për Regjistrim të Pengut, me nr. R-20190213 dhe sipas dispozitave të shtjelluara më lartë, ky dokument paraqet titull ekzekutiv dhe si i tillë është i përshtatshëm për përmbarrim.

Ndër të tjera, dokumenti përmbartimor Marrëveshja mbi Kredi Nr.200669060, e datës 12.08.2010 së bashku me shtojcën Marrëveshjen mbi Pengun është e përshtatshme për përmbartim pasi në të njëjtën janë treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit e që është në përputhje me nenin 27, paragrafi 1 të LPP-së, i cili parasheh “*Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.*”.

Meqenëse debitorët me ankesë nuk ka paraqitur asnjë shkak me të cilin do të vërtetonte se ekzistojnë arsye të cilat do të bënin dokumentin të pa përshtatshëm për tu përmbartuar, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur e ka refuzuar prapësimin si të pabazuar duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, duke e konsideruar vendimin e gjykatës së shkallës së parë të drejtë dhe të ligjshëm.

Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane, apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbartimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund t’i shkaktohet çfarëdo lloji dëmi me rastin e kryerjes së përmbartimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë, të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil, pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbartimit në këtë rast.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në procedurën përmbartimore “në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 208 e 209 pika (b) të LPK, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.A.P.nr.1498/2023, me datë 22.04.2024.

Gjyqtari  
Besnik Bislimaj